

Pyetjet e qytetarëve:

1. **Urim Krasniqi-Astrazup**-Jam nje qytetar nga fshati Astrazup deshta me ju pyet se kur do te rregullohet ujsjellsi ne lagjen e krasniqve, e dyta akoma nuk jan vendosur tabelat per emerimin e rrugeve ne kete lagje dmth lagjen krasniqi kur do te vendosen keto pllaka per emerimin e dy rrugeve, e treta eshte per ndriqimin publik ne rrugen kryesore qe jan demtuar a do te rregullohen dhe kur, pres pergjegjie nga ju faleminderit per mirkuptim.

**Përgjigjet:** Ujësjiellësi është në procedurë të tenderimit dhe shumë shpejt pritet të përfundoj. Siç e dini ujësjiellësi në lagjen tuaj, është dëmtuar nga vet banorët. Të gjitha rrugët kryesore kanë emërtime dhe janë të vendosura tabelat. Edhe ndriçimi është në procedurë dhe do të mirëmbahet, sikur çdo investim tjetër.

2. **Armend Krasniqi-kryetar i fshatit Terpezë e Poshtme**- Pershendetje i nderuar kryetar , drejtorë te komunes , dhe koleg ,kryetarë te fshatrave ! Po e fillojme kete leter me ngushllimin e familjareve te cilet kane humbur me te dashurit e tyre ne lufte me pandemin e Coronavirusit covid-19 ! Une urojë qe kjo gjendje te kaloje sa me shpejtë qe te shrohen te gjithë te prekurit nga kjo pandemi me te cilen eshte duke u ballafaquar i gjithë njerzimi !

Tash po fillojm me projekte e komunes se Malisheves te cilet i ka ber komuna ! E shikova edhe prezantimin tuaj eshte me te vertet me te ardh keq , sepse asnje projekt nuk eshte fillu ne fshatin tim Terpeze e poshtme ,ne vitin 2019 . Kjo eshte per marre se si na keni neglizhu sepse edhe ne jem pjes e kesaj komun edhe ne pagujmë taksa ne kete komunë ! Gjithashtu edhe projekti i cili eshte fillu ne vitin 2018 i kanalizimit nuk eshte perfunduar ende per kete jeni ne njohuri jo vetem ju por njerzit qe tash qe jane ministra e juaj te nismes ne Prishtin por nuk keni ndermmare asgje ne kete drejtim ! Une gjithmon kam kerkuar nga kryetari nga te gjithë drejtorat e komunes se malisheves qe projektit e fshatit tim te fillojne dhe te kryhen . Por asnjeher nuk i keni marr parasysh kerkesat tona !

Kurse fshatrat per rreth siq jane ,Carralluka Terpeza dhe Shkarashniku , Jane kry me shum se dy ose tri investimi kjo per faktin sepse e kan nga nje drejtor ne Komunen e Malisheves dhe kjo ka ndiku qe te investon komuna neper keto fshatra , kurse fshatin terpeze e poshtme e keni lan pa kurrfar investimi kjo eshte tmerr ne asnje komun nuk ndodh keshtu se si ka ndodh ne komun time per fshatin tim . Te jeni bindur qe na si fshat nuk do rrin duar kryq shume shpejtë do te dalum me deklarat neper media tona lokale te komunes se Malisheves dhe me gjerë ! Ne urojmë qe komun te merret me projekte e tona te vitit 2019-2020 !

Po filloj me projektet e vitit 2018 i vetmi projekt qe ka qen i oaraprë ne fshatin tim ka qen kanalizimi i pjes se lagjes ne anen e poshtme , Projekt i cili prej fillimit kam then qe eshte jasht fubksionit mirepo per shkak te presion nga ana e juaj qe projektit do te jete funksional ne e kemi

pranuar gjate procesit te pubes se kanalizimit kemi pas vrejtje te medha per punen e firmes per te cilen jeni njoftuar edhe ju si me shkrim ashtu edhe duke e vizituar edhe vete punimit e ketijë projektit ! Kryetarë une me sa pashe as ne vitin 2020 por keni ber planfikimin e rregullimit te ketijë kanalizimit sepse eshte jashte fubksionit dhe ka fillu edhe me demtu pronat e qytetareve . Kryetarë pas shum konsultimeve qe i kemi ber ne zyren tuaj dhe neper zyre te drejtorave tu prap nuk keni nderrmarr asgje njejt sikur ne vitin 2019 kryetarë eshte shanca e fundit per ju si komun qe te intervenoni ne kete projekt qe e keni ber keq ! Kur do te rregullohet ky prblem kryetarë ?

Viti 2019:

Kanalizim : Nuk kena pas edhe pse une e kam dit qe ju e keni fut kete projektin e 2018 qe ta përfundoni por jo .

Ndertimi i trotuar i keni ne planfikim te vitit 2019 por nuk eshte ber .

PSE?

Ndertimi i parkut brenda fshatit ! Ne planifikim te buxhetit eshte i paraparë qe te ndertohet sebashku me te maralies dikun rrrth 40.000€ Parku i fshatit time eshte 10.000 euro te ndara kurse i fshatit 30.000 kjo eshte e tmerrshem ! Ky park asnjeher nuk eshte fillu mu ndertu ne fshatin tim edhe pse ka qen i planifikuar . Kurse i Maralies eshte ndertu kryetar ka perfundu kurse i im jo . PSE ?

Ndrimqim publik 2019 ka qen i planifikuar pse nuk eshtë ardh ndriqim publik kurse neper fshatra tjerë veq kane perfunduar kryetarë .

PSE ne fshatin tim nuk eshte ardhë ndriqimi publik?

Viti 2020. Ne planfikimin e buxhetit prap fshati i im nuk eshte parapara rregullimi i kanalizimit kryetarë . Kjo eshte per marre .Qka jeni duke berë .

Ne ketë vit jane paraparë qe te asfaltohen rruget e fshatit , por as keto nuk kan fillu Eshte paraparë qe te tket edhe ndriqim publikë por ende ska ardh . gjithashtu edhe trotuar eshte planifikuar por ende nuk ka ardh .

Kryetarë kjo gjendje siq eshte duke e vazhduar me fshatin tim une si banorë edhe përfaqësues i ketij fshatit jemi lodh me juve ma duke ardhur neper zyrë dhe duke diskutuar dhe asgke nuk keni nderrmarr deri ne keto momente .

Kryetarë pse asnjeher nuk pergjigji ne email te cilet une i dergoje ne kerkesat e mija me shkrim pse asnjeher ju e as drejtoritë e tua nuk pergjigjen a ban me ditë arsyen . A nuk po dojn apo nuk

e din. Une kam shkruar shum email shum kërkesa shum problem por asnjeher skam marr pergjigje me shkrim nga ana e juaj !

Kryetarë e kem edhe problemin e derdhjes se ujerave te zeza neper lumin i cili kalonne fshatin tonë . Une gjate kohes se Pandemies kam ber nje denoncim kubder nje biznesit Qe eshte duke ber shkarkimin e ujervae te zeza ne lumin tonë por asnjeher nuk keni ndermarrë asgke kryetarë , Eshte mir mu marr edhe me ketë rast ?

Ube uroj qe te gjeni kohë dhe te pergjigjen ne secilen pyetje qe kam dergu dhe ne secilen kerkesë qe e kam ber ne Komunen e tuaj . Eshte mir prpjektet e mbetura qe te fillohet te impletohen me shpejtë sepse keto ndikojn ne jeten e qytetareve drejtpërdrejt ! Gjithë te mirat !

#### **Përgjigjet:**

I nderuar kryetar i fshatit Tërpezë e Poshtme, fillimisht po e sqarojmë dhe njëherë se prezantimi është për gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 dhe s'ka të bëjë me punët e kryera gjatë viteve të kaluara, por kjo nuk do të thotë që të mos përgjigjem edhe për çështjet e ngritura për vitet paraprake. Investimet, nuk bëhen në baza partiake, e as në vendbanime që kanë drejtor në drejtoritë komunale, pasi në çdo fshat apo vendbanim jemi të obliguar të investojmë pa dallime të tilla. Jo vetëm në fshatin tuaj, por në asnjë fshat ende nuk kanë filluar të realizohen projektet për shkak të vonesave në zhvillimin e procedurave të prokurimit, pasi për shkak të pandemisë me COVID-19, e kemi pasur të ndaluar të zhvillojmë procedura të prokurimit.

Po ashtu, duhet ta keni parasysh, se projektet votohen në Kuvendin e Komunës dhe investimet ndahen në 43 vendbanime dhe në qytetin e Malishevës, në mënyrë të barabartë, prandaj duhet të keni parasysh edhe mundësitë buxhetore që ka një komunë si Malisheva.

Në fshatin Tërpezë e Poshtme, kemi bërë edhe një shpim për ujë për pije për shkollën e fshatit mbi tetë mijë euro.

**Kanalizimi:** Jemi në proces e sipër të ndërtimit të sistemeve të kanalizimeve në çdo vendbanim dhe gradualisht në secilin vendbanim kjo do të përfundoj. Në fshatin tuaj siç jeni të informuar janë realizuar 2500m kanalizim nga dy degëzimet e fshatit por pavarësisht kësaj ende nuk është arritur që të përfundoj i tërë kanalizimi. Ju informojmë që pjesa e mbetur e këtij projekti është në procedurë.

#### **Trotuar:**

Në planifikimin e buxhetit për investime në vitin 2019, trotuar në Tërpezë të Poshtme, nuk ka pasur të planifikuar, apo të miratuar në KK.

(0620625660-193533049107Ndertimi i trotuarve ne fsh.Malisheve,Gurbardh,Carralluk,Terpeze,Pagarushe,Gajrak,Malisheve-aGajrakIadroc,Panorc,Kijeve,Astrazub,Senik,Shkoze,Bardhe,Vermice,Turjak,Drenoc,Lubizhd)

Trotuari është i planifikuar për këtë vit të ndërtohen 550 metra trotuar.

#### **Parku:**

Parku ka qenë në planifikim, por për shkak të mungesës së mjeteve të pakta dhe mungesës së projektit nuk është realizu.

#### **Ndriçimi publik:**

Ndriçimi publik për Tërpezë të Poshtme, në vitin 2019 nuk ka mundur të realizohet dhe i njëjti është i planifikuar për këtë vit dhe sigurisht që brenda vitit do të përfundoj.

#### **Rrugët:**

Implementimi i projekteve për këtë vit, ku përfshihen edhe rrugët, jo vetëm në fshatin tuaj, është në proces e sipër, pasi deri më tani nuk kemi pasur të drejtë të zhvillojmë procedura, për shkak të situatës. Janë të parapara të ndërtohen 1150 metra rrugë.

#### **Derdhja e kanalizimeve në përroskën e fshatit:**

Ky është problem i përgjithshëm, jo vetëm në fshatin tuaj apo në komunën tonë, por në tërë vendin. Gradualisht jemi duke punuar në ndërtimin e kolektorëve dhe brenda një kohe do të zgjidhet edhe ky problem.

#### **Projektet e planifikuara për këtë vit:**

Projektet e planifikuara për këtë vit, janë në procedurë e sipër, por gjithmonë duhet të keni parasysh se jemi në situatë emergjente shëndetësore dhe deri në muajin e kaluar nuk kemi mundur të zhvillojmë procedura për fillimin e implementimit të projekteve, jo vetën në fshatin tuaj, por as në fshatrat tjerë.

#### **Pse skam marrë përgjigje me shkrim:**

Përderisa keni qenë këtu në zyre dhe kemi biseduar disa herë, kam konsideruar se keni marrë përgjigje direkte, prandaj edhe nuk ju kam përgjigjur edhe me shkrim. Kthimi i përgjigjeve në çfarëdo forme, nuk paraqet ndonjë problem dhe jemi shumë transparent në këtë drejtim.